

UDHËZIM
Nr. 8, datë 26.8.2019

PËR KUSHTET E HOLLËSISHME TEKNIKE PËR USHTRIMIN E
VEPRIMTARISË NË STACIONET E NDËRZIMIT NATYROR NË GJEDH

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 53, pika 2, e ligjit nr. 9426, datë 6.10.2005 “Për mbarështimin e blegtorisë”, të ndryshuar, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nxjerr këtë Udhëzim:

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktoj kushtet e hollësishme teknike për ushtrimin e veprimtarisë së Stacionit të Ndërzimit Natyror të kontrolluar në gjedhë.

Neni 2
Përkufizime

1. “Stacion i ndërzimit natyror” është njësia epidemiologjike bujqësore me riprodhues meshkuj për çiftëzimin natyror të kafshëve femra të një ose disa fermave blegtorale.
2. “Qendra të prodhimit të kafshëve të racës” janë ferma agroblegtorale, stacione kërkimi dhe qendra industriale blegtorale, të specializuara për prodhimin dhe përhapjen e kafshëve me vlera të larta racore.
3. “Kartelë (certifikatë) gjenealogjike” është dokumenti, që shoqëron kafshët dhe që përmban të dhëna për identifikimin dhe vlerat racore të kafshëve e të paraardhësve të tyre (prindërve dhe gjyshërve).
4. Kafshë riprodhuese me vlera racore janë vetëm ato kafshë të fermës, që në kohën e maturimit seksual janë të afta dhe të destinuara për riprodhim dhe që plotësojnë kërkesat e përshkruara në programet racore të miratuara.
5. Qendra Kombëtare e Referencës, nënkupton Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë-Krujë.
6. “Certifikatë veterinarë” është certifikata e lëshuar nga veterineri zyrtar ose i autorizuar në përputhje me dispozitat e nenit 55 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës dhe të Ujit të OIE-së.
7. “Laborator i aprovuar” kuptojmë laboratorin e vendosur në QTTB Fushë-Krujë, e caktuar nga organet kompetente për të testuar në bazë të rregullores.

Neni 3
Kriteret për riprodhuesit meshkuj

1. Riprodhuesit meshkuj, të prodhuar në vend ose të importuar, që do të përdoren për ndërzim natyral të kontrolluar duhet të jenë kafshë racë-pastër.
2. Riprodhuesit meshkuj që do të përdoren për përmirësim racor nëpërmjet ndërzimit artificial ose natyror, duhet t’i jenë nënshtruar vlerësimit në një stacion prove të miratuar ose organizatë tjetër e mbarështimit të kafshëve, e cila ka kryer përpunimin e të dhënave nga matjet, provat, llogaritjet dhe ka publikuar apo disponon rezultatet për secilin riprodhues.
3. Të jenë të identifikuar dhe regjistruar sipas nenit 6, pika1, e ligjit nr. 10 465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Të jenë të regjistruar në Librin Gjenealogjik të racës përkatëse dhe regjistrimi të vërtetohet me anë të Kartelës (Certifikatës) gjenealogjike, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

5. T'i nënshtrohen kontrollit të masave sanitaro-veterinare dhe sëmundjeve infektive dhe zoonotike të hartuar nga autoriteti kompetent sipas programit veterinar për specien përkatëse;

6. Të kenë fletë-analizën për cilësinë e materialit biologjik (spermës) nga Drejtoria Teknologjive Blegtorale, Sektori i Punës Racore në QTTB Fushë-Krujë;

7. Kur në territor nuk ekziston shoqatë dhe nuk ka program racor të miratuar, të racës përkatëse, vepron si vijon:

a) Riprodhuesi/it meshkuj, që do të përdoren për Ndërzim Natyral të Kontrolluar, duhet të kenë të identifikuar paraardhësit për të paktën dy gjenerata dhe bazuar në vlerësimin e tipareve fenotipike të jenë pajisur me Kartelën (Certifikatën) gjenealogjike.

b) Të jetë bërë analiza e spermës nga laborator i njohur zyrtarisht dhe të rezultojë brenda parametrave teknikë;

c) Të jetë regjistruar si kafshë Riprodhuese Racë-pastër në Regjistrin e racës përkatëse, që do të mbahet nga specialisti i prodhimit shtazor (zooteknik) në Agjencinë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB) që mbulon territorin ku ushtron veprimtarinë ky subjekt.

Neni 4

Kushtet për Stacionet e Ndërzimit Natyror

1. Stacionet e ndërzimit natyror lejohen të përdorin riprodhues meshkuj racë-pastër me prejardhje të plotë (që përfshin informacion për jo më pak se dy gjenerata paraardhëse) të pasqyruara në Kartelën (certifikatën) Gjenealogjike.

2. Stacioni i ndërzimit natyror e ushtron veprimtarinë, nëse plotëson kriteret për personelin teknik, pajisjet, mjetet dhe riprodhuesit meshkuj.

3. Subjektet për ngritjen e një Stacioni të Ndërzimit Natyror të kontrolluar, e ushtrojnë aktivitetin e tyre mbi bazën e regjistrimit në Qendrën Kombëtar të Biznesit, me objekt ushtrimin e veprimtarisë së ndërzimit natyror të kontrolluar në gjedhë.

4. Subjekti duhet të mbajë në ambientet e veta për efekt kontrolli nga institucionet përgjegjëse, informacionin për:

a) Subjektet që u ofrohet shërbimi i ndërzimit natyror me data dhe firmë të pronarëve/kujdestarëve të kafshëve (lopëve) të ndërzyera, të regjistruar në mënyrë kronologjike;

b) Kopje të të gjitha akt-kontrolleve të ushtruara nga strukturat e kontrollit.

5. Të disponojnë ambiente të veçuara dhe të përshtatshme për mbarështimin e riprodhuesit/ëve me mundësi për izolimin e tyre si dhe vend të përshtatshëm për ndërzim, me pajisje të nevojshme etj.

6. Të plotësojë kushtet e sigurimit teknik për njerëzit dhe kafshët si rrethimi mbrojtës, vendosja e unazave metalike, etj.

7. Të mbajë në stacion librin e mjekimeve modelin e miratuar, për zbatimin e programeve të masave sanitaro-veterinare dhe trajtimeve terapeutike, si dhe të lajmëroje shërbimin veterinar rajonal, për çdo dyshim ose sëmundje të shfaqur në kafshët e riprodhimit në stacion.

8. Të regjistrojë për çdo riprodhues që përdor:

- Specien;
- Racën;
- Vend-origjinën;
- Datën e lindjes;
- Numrin e identifikimit (matrikullin);
- Sëmundjet dhe trajtimet.

9. Të pranojë kontrollet zyrtare dhe të vëri në dispozicion të tyre të gjithë dokumentacionin si dhe materialin biologjik për analizë (kur i kërkohet).

10. Të bëjë autokontroll për cilësinë e materialit biologjik për çdo riprodhues një herë në 4 (katër) muaj;

11. Tekniku të jetë i kualifikuar për detyrat specifike që duhet të mbulojë dhe të jetë i regjistruar dhe anëtarësuar në Urdhrin e Mjekut Veterinar.

Neni 5

Detyrat e Teknikut të Ndërzimit Natyror

1. Të regjistrojë të gjitha ndërzimet dhe regjistri të përmbajë:
 - Numrin e kartës së identitetit të pronarit të kafshës, shoqëruar me emër dhe mbiemër;
 - Numrin e matrikullit të riprodhuesit mashkull që kryen ndërzimin natyror;
 - Datat e ndërzimit;
 - Numrin e matrikullit të kafshës femër që ndërrehet.
2. Të mbajë fletoren e vlerësimit të spermës ose dosje me fletë-analizat periodike të vlerësimit të spermës.
3. Ka detyrimin t'i japi pronarit të kafshës femër të dhënat mbi ndërzimet.
4. Të sigurojë dhe mbajë dokumentacionin e Stacionit për të paktën 5 vjet.
5. Të zbatojë programet kombëtare të kontrollit të sëmundjeve që lidhen me Brucelozën; Leukozën; IBR; BVD Vibroze; Trikomonozen, TBC dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme.
6. Të zbatojë udhëzimet e Shërbimit Veterinar lidhur me profilaksinë.
7. Të informojë nëpërmjet veterinerit të zonës shfaqjen tek riprodhuesit e tij të çdo dyshimi mbi sëmundjet infektive dhe /parazitare.
8. Të ruajë certifikatat/kartelat e lëshuara të përmendura në këtë udhëzim.
9. Të mos mbajë në të njëjtin strehim kafshë të specieve të ndryshme.
10. Kur riprodhuesi është pjesë e një ferme ku mbarështohet e njëjta specie duhet të mbahet në mënyrë të veçantë nga pjesa tjetër e tufës.
11. Të dorëzojë dy herë në vit evidencat e ndërzimeve të kryera pranë AREB-it që mbulon atë territor.
12. Teknikut të stacionit të ndërzimit natyror i ndalohet përdorimi i riprodhuesve meshkuj të racave egzotike të gjedhit në habitatet ku mbahen populacionet autoktone të gjedhit (referuar Katalogut Kombëtar të Racave, që mbahet në QTTB Fushë-Krujë).

Neni 6

Kontrolli i aktivitetit në fushën e ndërzimit natyror

1. Strukturat e kontrollit (Veterineri në shërbimin veterinar rajonal në ARSHVMB dhe specialisti i prodhimit shtazor (zooteknik) që mbulojnë territorin përkatës) duhet të ushtrojnë kontrolle periodike për dokumentacionin, përshtatshmërinë e riprodhuesve meshkuj, mjedisve dhe pajisjeve, duke bërë rekomandime për përmirësim ose duke ekzekutuar masa administrative në rastet e nevojshme. Një kopje e akt-kontrollit i lihet subjektit që kontrollohet;
2. Strukturat e kontrollit kanë detyrimin për të verifikuar në vijimësi vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti si dhe praninë e korrektësinë e dokumentacionit përkatës në përputhje me ligjin nr. 9426 “Për mbarështimin e blegtorisë”, të ndryshuar, nenin 118, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011. “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe këtë udhëzim;
3. Brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e kontrollit përgatitet akt-kontrolli, ku, një kopje i dërgohet subjektit dhe një kopje mbahet në Sektorët përkatës të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve (SHVMB), të Ekstensionit Bujqësor si dhe në zyrat rajonale të këtyre shërbimeve ASHVMB dhe AREB-in përkatës. Në rastin kur vetëdeklarimi dhe kushtet për kryerjen e aktivitetit nga kontrollet periodike rezultojnë se nuk janë në përputhje me ligjin nr. 9426 “Për mbarështimin e blegtorisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar

në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe këtë udhëzim, merren masat administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Subjektet që ushtrojnë këtë aktivitet kanë të drejtën e ankimimit ndaj vendimit të marrë.

5. Veterineri Zyrtar në nivel ASHVMB dhe Specialisti i prodhimit shtazor (zooteknik) në nivel AREB-i mbajnë regjistrin e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e ndërzimit natyror të kontrolluar dhe arkivon dokumentacionin përkatës për çdo subjekt.

Neni 7 **Zbatimi**

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit; Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural; QTTB Fushë-Krujë; agjencitë rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe agjencitë rajonale të Ekstensionit Bujqësor.

Shfuqizohen nenet 17, 18 dhe 19 të rregullores nr. 2, datë 22.7.2008 “Për riprodhimin e kafshëve të fermës, prodhimin e tregtimin e materialeve racore”.

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

